


AKSESUESHMËRIA DHE COVID-19



Personat me aftësi të kufizuara në shumë vende po humbin informacion jetësor për Covid-19 (koronavirus). Kjo sepse informacioni nuk vihet në dispozicion në formate të arritshme.

Është shumë e rëndësishme që informacioni dhe komunikimi i shëndetit publik në lidhje me Covid-19 të jetë plotësisht i arritshëm për të gjithë dhe që personat me aftësi të kufizuara të mund të jenë të përditësuar për ndryshimin e këshillave shëndetësore.

CILAT JANË FORMAT E ARRITSHME?





Dëgjim
i asistuar



Lexues
ekrani



Kontrast
i lartë



Gjuhë e
thjeshtë
dhe e qartë
(duke përfshirë
easy read)

ÇFARË DO TË THOTË KJO?

Formati i arritshëm rreth Covid-19 duhet të përfshijë:

- Këshilla për shëndetin dhe higjenën
- Shërbimet e ofruara
- Planet e kufizimit publik
- Këshilla për të zvogëluar rrezikun

Komunikimet e medias, informimet e përditshme nga Kombet e Bashkuara si dhe informacioni nga Organizata Botërore e Shëndetësisë duhet gjithashtu të jenë të arritshme.

Ky dokument është përgatitur nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në kuadrin e projektit " COVID-19, Reagim Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar", të mbështetur financiarisht nga Ballkan Trust for Democracy(BTD). Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e BTD.

Për të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe Covid-19, ju mund të lexoni materialet e publikuara në faqen tonë: <https://platforma-pak.al/te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-covid-19/>, ku keni dhe hapësirën e posaçme dedikuar për pyetjet tuaja.